



## VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

**Data e miratimit:** 23 nëntor 2011

**Numri i lëndës** 2011-06

**Milazim Blakqori**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore  
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PARA PANELIT**

1. Ankesa ishte regjistruar më 1 prill 2011.

### **II. FAKTET**

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panel, mund të përmbliidhen si në vijim.

### *Parathënie*

3. Më 17 shkurt 2005 parashtruesi i ankesës dhe një palë e tretë kishin arritur një marrëveshje për shitjen e "Hotel Park" dhe vendparkimin të bashkangjitur me të në rrugën Gustav Majer në Prishtinë. Parashtruesi i ankesës duke besuar që ai ishte bërë pronar i ligjshëm kishte filluar të investoj në atë pronë.
4. Për arsye të panjohura, rreth kësaj prone ishte ngritur një kontest ndërmjet parashtruesit të ankesës dhe palës së tretë. Kjo e kishte penguar parashtruesin e ankesës që ta shfrytëzoi pronën siç parashihej dhe kjo kishte çuar edhe në humbje të mëdha financiare.

### *Procedurat administrative dhe gjyqësore*

5. Më 4 dhjetor 2006, parashtruesi i ankesës ka dorëzuar një kërkesë në Gjykatën Komunale të Prishtinës, duke kërkuar masa të përkohshme/parandaluese mbrojtëse lidhur me pronën në kontest.
6. Me vendimin e datës 23 janar 2007 Gjykata Komunale e Prishtinës ka miratuar kërkesën e parashtruesit të ankesës dhe ka bërë thirrje për shtyrje të bartjes apo shitjes së pronës kontestuese për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh. Për më tej, Gjykata ka deklaruar se ky vendim duhet të zbatohet nga institucionet vendore dhe parashtruesi i ankesës duhet të parashtrroj padi në mënyrë që të procedohet lënda, ashtu siç kishte dorëzuar dokumentet prej datës 24 janar dhe 21 shkurt 2007.
7. Më 1 mars 2008 parashtruesi i ankesës dhe pala e tretë siç duket kanë arritur një marrëveshje tjetër lidhur me pronën. Përbërja e marrëveshjes nuk është e njohur për Panelin.
8. Sidoqoftë, më 5 maj 2008 pala e tretë ka dorëzuar një kërkesë tek Drejtori për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Prishtinës për leje ndërtimi, e cila ishte lëshuar më 16 korrik 2008.
9. Përpjekja e parashtruesit të ankesës për të shfuqizuar lejen e ndërtimit dhe për ta ndaluar ndërtimin në pronën kontestuese ishte hedhur poshtë nga e njëjta Drejtori më 2 dhjetor 2008.
10. Më 17 dhjetor 2008 parashtruesi i ankesës kishte dorëzuar një kërkesë të njëjtë te Zyra qeveritare e Sekretariatit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Më 17 mars 2009 kjo kërkesë gjithashtu ishte hedhur poshtë mbi bazën se rasti mund të zgjidhet vetëm në procedurë gjyqësore.
11. Më 5 mars 2009 Gjykata Komunale e Prishtinës ka lëshuar një vendim, përmbajtja e së cilës nuk është e njohur për Panelin. Më pastaj, ky vendim ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës më 18 janar 2010 dhe rasti ishte rikthyer në Gjykatën Komunale.

12. Më 24 gusht 2010 parashtuesi i ankesës kishte ngritur padi në Gjykatën Komunale kundër Komunës së Prishtinës duke kërkuar kompensim për shkak të dështimit të institucioneve publike për të zbatuar vendimin e Gjykatës së datës 23 janar 2007.

#### *Përfshirja e EULEX-it*

13. Gjatë procedurave administrative dhe juridike, parashtuesi i ankesës ka dërguar një letër tek Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it duke pohuar se vendimi fillestar i Gjykatës Komunale të Prishtinës i datës 23 janar 2007 nuk ishte zbatuar e as respektuar nga institucionet vendore.
14. Më 26 janar 2010 një gjykatës civil i EULEX-it në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës i është përgjigjur kërkesës së parashtuesit të ankesës duke deklaruar se EULEX-i nuk do të merr përsipër lëndën pasi që kushtet që përcaktohen në Nenin 5.1 (c) nën (i) deri në (iii) Ligji mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Ligji nr. 03/L-053 nuk ishin plotësuar.

### **III. ANKESAT**

15. Parashtuesi i ankesës pretendon se institucionet vendore as nuk e kanë respektuar e as zbatuar vendimin e lëshuar më 23 janar 2007 nga Gjykata Komunale e Prishtinës.

### **IV. LIGJI**

16. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës (RrP).
17. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave siç përcaktohet në Rregullën 25, paragrafin 1 të RrP së vet.
18. Sipas Rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhënies në PLANIN OPERATIV të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore të gjykatave të Kosovës. Në veçanti, nuk është funksion i tij që të merret me gabimet e faktit apo ligjit që supozohet të jenë kryer nga gjykatat vendore, përveç apo në atë masë sa ata do të kishin shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i zbatueshëm në Kosovë. Prandaj, Paneli nuk ka kompetencë për të shqyrtuar veprimet dhe lëshimet e gjykatave të Kosovës dhe autoriteteve të tjera.

19. Në përputhje me Rregullën 25, paragrafi 3 i Rregullores së Punës<sup>1</sup> ankesat duhet të dorëzohen brenda tre muajve nga data kur Paneli mund të pranoj ankesën (9 qershor 2010), apo brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar, cila do që të jetë më e përshtatshme për parashtruesin e ankesës.
20. Paneli konstaton se vendimi i EULEX-it në Kosovë që mos ta merr përsipër lëndën e parashtruesit të ankesës ishte komunikuar tek ai më 26 janar 2010. Ankesa duhej të ishte parashtruar më së voni më 9 shtator 2010. Ankesa ishte parashtruar më 1 prill 2011. Kështu që, ankesa nuk plotëson kërkesën e Rregullës 25, paragrafi 3 i Rregullores së Punës.
21. Sa i përket procedurave administrative në këtë lëndë, Paneli deklaron se EULEX-i në asnjë rast nuk është përfshirë dhe se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar vendimet dhe veprimet e institucioneve administrative vendore.

#### **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

*konstaton* se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë,

*gjen* se ankesa është e pabazuar sipas Rregullës 29 (d) dhe Rregullës 25, paragrafi 3 i Rregullores së Punës së vet, dhe

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit

---

<sup>1</sup> Siç është shprehur në versionin në fuqi të datës 9 qershor 2010, në kohën kur është parashtruar kjo ankesë.